



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 dhjetor 2013
Nr. ref.:RK530/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI100/13

Parashtrues

Selim Hajra

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. I. nr. 29/2009, të 25 janarit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Selim Hajra (në tekstin e mëtejme: parashtruesi) nga fshati Krasaliq, komuna e Skenderajt.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I. nr. 29/2009, të 25 janarit 2012, të cilin e ka pranuar më 13 qershor 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi pretendon se i janë cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe atë me nenin 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme]; nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit]; nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; si dhe nenin 1 të Protokollit I të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 22 dhe 47 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 korrik 2013, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatë.
6. Më 5 gusht 2013, Kryetari e caktoi gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
7. Më 4 shtator 2013, Sekretariati e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Në të njëjtën ditë, Sekretariati e njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 18 tetor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 28 mars 2003, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër Ministrisë së Punë dhe të Mirëqenies Sociale (MPMS) përmes së cilës kishte kërkuar "*kthim në vendin e punës dhe kompensimi i të ardhurave personale*".
11. Sipas tij, parashtruesi ka qenë në marrëdhënie të përhershme pune me MPMS-në nga 11 qershori 1970 deri më 1 tetor 2001, ndërsa të ardhurat personale i ka realizuar deri më 1 tetor 1999. Për periudhën tjetër nuk ka realizuar të ardhura

personale. Më 25 shtator 2000, MPMS-ja kishte shpallur konkurs për pranimin e punëtorëve të rinj, gjatë të cilit konkurs, shumica e punëtorëve të mëparshëm nuk kanë arritur të punësohen duke bërë kështu shkeljen e *“ligjit në fuqi mbi marrëdhëniet e punës, duke shkelur statusin juridik të paditësit i cili gjerë në atë moment ishte në marrëdhënie pune te e paditura... dhe në të njëjtën kohë e paditura nuk lëshon asnjë vendim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës”*.

12. Më 23 shtator 2004, Gjykata Komunale, me Aktgjykimin Cl. nr. 105/2003, e refuzon si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit, pasi që ajo *“nuk ka ndonjë provë se paditësi me të padituren ka qenë ndonjëherë në ndonjë raport eventual detyrimor”*. Sipas Gjykatës Komunale, parashtruesi ka qenë në marrëdhënie pune me Fondin Republikan të Serbisë për Sigurim Pensional dhe Invalidor të të Punësuarve në Prishtinë deri në sulmet e NATO-s, gjatë së cilës periudhë, edhe i ka realizuar të ardhurat e tij.
13. Më tutje, Gjykata Komunale konstaton se, *“as departamentet e mëhershme dhe as Ministria për Punë e Mirëqenie Sociale nuk e kanë vazhdimësinë e as nuk janë trashëgimtarë të asnjë institucioni të Kosovës nga periudha e paraluftës, çka do të thotë se nuk janë suksesore as të Fondit të atëhershëm Republikan (të Serbisë) për Sigurim Pensional e Invalidor të të Punësuarëve në Kosovë-punëtor i së cilës ka qenë paditësi.”* Gjykata Komunale arrin në përfundim se *“kërkesëpadia e paditësit është drejtuar ndaj një subjekti i cili nuk ka kurrfarë detyrimi ndaj paditësit, ngase asnjëherë nuk janë gjetur në kurrfarë raporti materialo-juridik, nga i cili do të kishin të drejta dhe detyrime të ndërsjella”*.
14. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, Cl. nr. 105/2003, parashtruesi paraqet ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale; vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike; dhe aplikim të gabuar të dispozitave të ligjit material, duke kërkuar anulimin e këtij aktgjykimi dhe që lëndën ta vendosë në mënyrë meritore ose ta kthejë atë në shkallë të parë për rishqyrtim dhe vendosje.
15. Më 5 qershor 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin Ac. nr. 874/06, e refuzon si të pabazuar ankesën e të autorizuarit të paditësit Selim Hajra nga Prishtina dhe vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, Cl. nr. 105/2003. Sipas kësaj gjykate, *“gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke konstatuar se e paditura ka legjitimitet pasiv në këtë çështje juridike, ... andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.”* Më tutje Gjykata e Qarkut konstaton se *“pranimi i punëtorëve të rinj është bërë në pajtim me rregullat juridike të aplikueshme për shërbimin civil në Kosovës me të cilat është paraparë që departamenti të përkujdeset që i tërë punësimi të mbështetet në përgatitjet profesionale, në aftësi dhe në merita dhe në harmoni me kushtet e konkursit të dt. 25 shtator 2000.”*
16. Më 21 nëntor 2008, parashtruesi paraqet revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, Ac. nr. 874/2006, për shkak të *“aplikimit të gabuar të dispozitave materiale”*.
17. Më 25 janar 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykim Rev. I. nr. 29/2009, e refuzon si të pabazuar revizionin e parashtruesit, të paraqitur

kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 874/2006, duke e konsideruar *“si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës më të ulët sipas të cilit është refuzuar kërkesëpadia e paditësit”*.

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi pretendon se gjatë procedurës në gjykatat e rregullta, i janë shkëlur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkitazi me nenin 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme]; nenin 49 [E Drejta e Punës dhe e Ushtrimit të Profesionit]; neni 46 [Mbrojtja e Pronës]; nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; si dhe nenin 1 të Protokollit I të KEDNJ-së.
19. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që *“e paditura të më kthejë në punët dhe detyrat e punës së mëparshme”* dhe *“që e paditura të mi paguaj të ardhurat personale duke filluar prej 1 tetor 1999 e deri më ditën e daljes në pension-me kamatë ligjore dhe shpenzimet gjyqësore”*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë, të cilat specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregullore.
21. Gjykata së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesi është palë e autorizuar që të parashtojë kërkesë në Gjykatë në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës. Parashtruesi është person fizik dhe ka provuar se është palë e autorizuar në përputhje me dispozitën e lartcekur.
22. Gjykata, po ashtu, përcakton nëse parashtruesi ka provuar t'i ketë përmbushur kërkesat e nenit 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores, përkitazi me shterimin e mjeteve efektive juridike. Parashtruesi ka dorëzuar në Gjykatë prova të mjaftueshme për përmbushjen e kriterit të kërkuar me nenin dhe me dispozitat e lartcekura.
23. Gjithashtu, parashtruesi duhet të provojë që i ka përmbushur kërkesat e nenit 49 të Ligjit dhe të rregullit 36.1 (b) të Rregullores së punës, përkitazi me dorëzimin e kërkesës brenda afatit të paraparë ligjor. Nga shkresat e lëndës vërehet qartë se vendimi i fundit për rastin e parashtruesit është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 29/2009, i 25 janar 2012, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 13 qershor 2013, ndërsa parashtruesi kërkesën në Gjykatë e dorëzoi më 11 korrik 2013, që nënkupton se kërkesa është parashtruar brenda afatit 4-mujor të paraparë me dispozitat e lartcekura.
24. Më tutje, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

25. Për qëllime të pranueshmërisë, Gjykata, gjithashtu, duhet të marrë parasysh nëse kërkesa e parashtruesit i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2), që parashohin si në vijim:

(1) *“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

(c) *Kërkesa nuk është qartazi e pabazuar”*

(2) *“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

26. Sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e instancave më të ulëta dhe Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t’i interpretojnë dhe t’i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1;).

27. Prandaj, Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 13071/87, 10 korrik 1991).

28. Në rastin konkret, parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta kanë bërë shkelje të nenit 56 të Kushtetutës [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme], i cili nen aktivizohet vetëm në rastet e shpalljes zyrtare të gjendjes së jashtëzakonshme, sipas të cilit:

“1. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme sipas kësaj Kushtetute dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna.

2. Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38, të Kushtetutës nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash.”

29. Parashtruesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për shpallje të gjendjes së jashtëzakonshme gjatë periudhës kur pretendon se i është bërë shkelja e të drejtave të njeriut dhe Gjykata nuk ka ndonjë dokument apo informacion tjetër për të vërtetuar këtë.

30. Për më shumë, Gjykata nuk mund të konstatojë se parashtruesit i janë cenuar të drejtat e tij kushtetuese, të cilat pretendon se i janë shkelur, ndërsa fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të pranueshme për shkelje të neneve të pretenduara të Kushtetutës (shih Memetoviq kundër Gjykatës Supreme të Kosovës KI 50/10, 21 mars 2011; shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
31. Pas shqyrtimit të procedurave në Gjykatën Supreme, e cila e hodhi poshtë revizionin e parashtruesit ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut si të pabazuar, për shkak të arsyeve kryesisht të përmendura në aktgjykimin e Gjykatës Komonale, Gjykata Kushtetuese nuk gjen që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, Nr. 17064/06, i 31 majit 2009).
32. Si konkluzion, parashtruesi i kërkesës as nuk ka arritur të ndërtojë rastin për shkeljen e të drejtave, në të cilat ai thirret, dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e tillë (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005 dhe Rasti KI 70/11, Faik Hima, Magbule Hima, Bestar Hima, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011, Aktvendimi për papranueshmëri, i 13 dhjetorit 2011).
33. Prandaj, rezulton që kërkesa është qartazi e pabazuar dhe si e tillë e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36 (2) a) dhe b) si dhe rregullin 56.2 të Rregullores, më 18 tetor 2013,

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim t'u komunikohet palëve dhe të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani